

Termat e referencës: “Ekspert për studimin dhe hartimin e një plani për vlerësimin e situatës së erozionit në fshatin Shtiqën, pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik-PNKK”, për AdZM Kukës, aktiviteti 2.2

1. Hyrje

Fshati Shtiqën, pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik është prekur nga fenomene të ndryshme të erozionit, të cilat kanë ndikuar në degradimin e tokës, humbjen e habitateve, humbjen e tokës bujqësore dhe dëmtimin e infrastrukturës. Për të vlerësuar situatën aktuale dhe për të propozuar masa efektive për parandalimin dhe menaxhimin e erozionit, kërkohet angazhimi i një eksperti me përvojë në këtë fushë. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), përmes Grantit të financuar nga PONT në Parkun Natyror Korab-Koritnik-PNKK (PA_027), duke zbatuar Planin Operacional 2025 të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar për këtë qëllim dhe si rrjedhim kërkon një ekspert për të kryer një studim dhe hartimin e një plani për vlerësimin e situatës së erozionit në fshatin Shtiqën, pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik-PNKK.

2. Objektivat

Objektivat kryesorë të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a) Vlerësimin e situatës aktuale të erozionit në fshatin Shtiqën, pjesë e PNKK.
- b) Identifikimin e faktorëve kryesorë që ndikojnë në përshpejtimin e erozionit në fshatin Shtiqën.
- c) Propozimin e masave për minimizimin e ndikimeve negative të erozionit dhe rehabilitimin e zonave të dëmtuara në fshat.
- d) Hartimin e një strategjie për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe parandalimin e degradimit të saj në këtë fshat.

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Fokusi i detyrës do të jetë Parku Natyror Korab-Koritnik-PNKK sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për studimin dhe hartimin e një plani për vlerësimin e situatës së erozionit në fshatin Shtiqën, pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik-PNKK” për AdZM Kukës lidhur me PNKK.

Eksperti do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme për studimin dhe planin e detajuar që do të hartojë:

- *Analizën e situatës aktuale të erozionit në zonë (fshati Shtiqën, pjesë e PNKK).*
- *Identifikimin e zonave më të rrezikuara dhe faktorëve që e shkaktojnë erozionin dhe përshpejtimin e tij.*
- *Rekomandime për masa parandaluese dhe ndërhyrje për stabilizimin e terrenit.*
- *Propozime për teknika dhe metoda të menaxhimit të qëndrueshëm të tokës.*
- *Hartimin e një plani veprimi me objektiva afatshkurtra dhe afatgjata për menaxhimin e erozionit në zonë (fshati Shtiqën, pjesë e PNKK).*

- *Produkti final (Raport studimi dhe plani i detajuar vlerësimi) sipas objektit të procedurës duhet të dorëzohet në format pdf dhe word, në mënyrë elektronike dhe fizikisht brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 5.*

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Eksperti duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në shkenca mjedisore, inxhinieri gjeoteknike, gjeografi, menaxhim të burimeve natyrore ose fusha të ngjashme.
- Eksperienca të mëparshme në studimin dhe menaxhimin e erozionit dhe degradimit të tokës.
- Njohuri mbi praktikat më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës dhe parandalimin e erozionit.
- Aftësi për të analizuar dhe vlerësuar ndikimet e ndryshimeve mjedisore dhe faktorëve gjeologjikë në erozionin e tokës.
- Eksperienca në bashkëpunimin me institucione dhe komunitete lokale për menaxhimin e burimeve natyrore.

5. Kohëzgjatja e konsulencës dhe dorëzimi i Produktit

Shërbimi i konsulencës fillon me nënshkrimin e kontratës respektive me ekspertin e shpallur fitues dhe do të përfundojë me dorëzimin e produktit final **brenda 7 (shtatë) javësh nga nënshkrimi i kontratës**, sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për vlerësimin e situatës së erozionit në fshatin Shtiqën, pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik-PNKK” për AdZM Kukës lidhur me PNKK.

6. Buxheti

Buxheti për kryerjen e procedurës së prokurimit shërbim konsulence i referohet zbatimit të linjave të buxhetit të përcaktuara në Planin Operacional 2025 të grantit të financuar nga PONT për PNKK, saktësisht:

- Aktiviteti Nr. 2.2 me objekt "Ekspert për vlerësimin e situatës së erozionit në fshatin Shtiqën, pjesë e Parkut Natyror Korab-Koritnik-PNKK” për AdZM Kukës lidhur me PNKK, **parashikuar në vlerën maksimale 7,000 (shtatë mijë) euro, ku përfshihet me tvsh ose 15% tatim në burim.**

7. Mënyra e Aplikimit dhe afati

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre me:

- CV-në e detajuar dhe
- Ofertën financiare sipas buxhetit të përcaktuar në planin operacional 2025 sipas pikës 6 më sipër

në adresën zyrtare të emailit: info@akzm.gov.al

Afati për aplikim është deri më datë **23 prill 2025** (përfshirë).